



**BASHKIA E TIRANËS
KËSHILLI BASHKIAK**

V E N D I M

Nr. 40 datë 23.09.2015

Për

**“MIRATIMI I PAGESËS PËR PAK DHE INVALIDËT E PUNËS PËR PERIUdhËN
1-30 SHTATOR 2015”**

Në mbështetje të Ligjit nr. 9355, datë 10.03.2005, “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”, i ndryshuar; Ligjit nr. 8153, datë 31.10.1996, “Për statusin e Jetimit”; Ligjit nr. 8098, datë 28.03.1996, “Për statusin e të verbërit”; Ligjit nr. 8626, datë 22.06.2000, “Statusi i Invalidit Paraplegjik dhe Tetraplegjik”; Ligjit nr. 7889, datë 14.12.1994, “Statusi i Invalidit të Punës”, i ndryshuar; V.K.M. nr. 904, datë 12.12.2011, “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurave dhe dokumentacionit të përfitimit të ndihmës ekonomike në zonat pilot”; V.K.M. nr. 375, datë 11.6.2014, për disa shtesa dhe ndryshime në V.K.M. nr. 904, datë 12.12.2012, “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurave dhe dokumentacionit të përfitimit të ndihmës ekonomike në zonat pilot”, Udhëzimit nr. 8, datë 23.6.2014 mbi përlogaritjen e përfitimit të ndihmës ekonomike, në zonat pilot ; Udhëzim nr. 9, datë 23.6.2014, mbi zbatimin e V.K.M. nr. 904, datë 12.12.2012, “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurave dhe të dokumentacionit të përfitimit të ndihmës ekonomike, në zonat pilot”; V.K.M. nr. 618, datë 07.09.2006, “Për përcaktimin e kriterëve të dokumentacionit dhe masës së përfitimit të pagesës për personat me aftësi të kufizuar”, i ndryshuar; Udhëzimit nr. 6, datë 07.08.2013, “Mbi zbatimin e V.K.M. nr. 618, datë 07.09.2006, “Për përcaktimin e kriterëve të dokumentacionit dhe të masës së përfitimit të pagesës për personat me aftësi të kufizuar”; V.K.M. nr. 277, datë 18.06.1997, “Për përfitimet nga statusi i të verbërit”, i ndryshuar; Udhëzimit nr. 2365, datë 26.11.2008, “Mbi zbatimin e V.K.M. nr. 277, datë 18.06.1997, “Për përfitimet nga statusi i të verbërit”; Udhëzimit nr. 7, datë 07.08.2013, Mbi zbatimin e V.K.M. nr. 277, datë 18.06.1997, “Për përfitimet nga statusi i të verbërit”; Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 31, datë 20.01.2001, “Për përfitimet nga statusi i invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik”, i ndryshuar; Udhëzimit nr. 5, datë 07.08.2013, mbi zbatimin e V.K.M. nr. 31, datë 20.01.2001, “Për përfitimet nga statusi i invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik”; V.K.M. nr. 869 datë 18.06.2008, “Për zbatimin e Ligjit nr.7889, datë 14.12.1994, “Statusi i Invalidit të Punës”; Udhëzimit nr. 1406, datë 30.07.2008, “Për përcaktimin e proceduarve dhe të dokumentacionit të nevojshëm për dhënien e përfitimit, në zbatim të V.K.M. nr. 869, datë 18.06.2008, “Për zbatimin e Ligjit nr.7889, datë 14.12.1994, “Statusi i invalidit”, i propozojmë Këshillit Bashkiak Tiranë, sa më poshtë:

V E N D O S I:

1. Të miratohet pagesa për personat me aftësi të kufizuara, për muajin Shtator për Njësitë Administrative të Bashkisë Tiranë sipas tabelës nr. 1 bashkëlidhur.
2. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Financës, Drejtoria e Menaxhimit të Strehimit dhe Shërbimeve Sociale dhe Njësitë Administrative të Bashkisë Tiranë.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 (dhjetë) ditë pas shpalljes.

K R Y E T A R

ALDRIN DALIPI